



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9944 prot.

Roskovec, më 24.12.2024

VENDIM

Nr. 76, datë 23.12.2024

PËR

**MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË ROSKOVEC
DHE NDËRMARRJES VARTËSE**

Në mbështetje të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja "b", nenit 54, shkronja "ç", nenit 55, pika 2, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", nenit 6, shkronja "c" dhe nenit 9, të ligjit nr.35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", Vendimit nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", ndryshuar me VKM-në nr.503, datë 1.8.2024, Vendimit nr.113, datë 01.03.2023, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Miratimin e nivelit të pagave për funksionarët, nëpunësit civilë, punonjësit administrativë të Bashkisë Roskovec sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike sipas lidhjes nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më 1 Janar 2025 dhe do të përballohen nga të ardhurat e Bashkisë Roskovec.
4. Ngarkohen Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Roskovec dhe Drejtoria e shërbimeve mbështetëse në Ndërmarrje për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Afrim Plaka